



Beratungsstelle Opferhilfe Solothurn  
Industriestrasse 78  
4600 Olten

Telefon: 062 311 86 66  
E-Mail: [opferberatung@ddi.so.ch](mailto:opferberatung@ddi.so.ch)

[opferhilfe.so.ch](http://opferhilfe.so.ch)

Ju jeni bërë viktimë e një veprave penale. Më poshtë dëshirojmë t'ju japim disa informacione.

### Zhvillimi i procedurës penale

Ju keni marrë nga policia formularin “Fletëkërkesë për ndjekje penale të delikteve që ndiqen në bazë të kërkesës /padi private”. Me këtë formular ju keni mundësinë të bëni një kallëzim penal dhe për këtë arsye jeni paditës/paditëse private në procedurë. Nëse nuk keni bërë ende një kërkesë për ndjekje penale, keni mundësinë ta bëni këtë brenda tre muajve nga data e veprës penale.

Nëse keni bërë kërkesë për ndjekje penale, prokuroria publike mund t'ju ftojë (përsëri) në pyetje. Përveç kësaj, ju mund të thirreni, së bashku me personin e akuzuar, në një seancë negociatash për marrëveshje. Qëllimi i këtyre negociatave është që personi i akuzuar t'ju kërkojë falje, të pranojë të mbulojë shpenzimet që keni bërë dhe mundësisht të paguajë një zhdëmtim. Në këmbim, ju të pranoni të tërhiqni kërkesën për ndjekje penale. Nëse arrihet në një marrëveshje (=zgjidhje), procedura përfundon. Nëse nuk dëshironi të hyni në marrëveshje, prokuroria publike do të vazhdojë hetimin. Nëse personi i akuzuar e pranon veprën ose ajo mund të provohet, zakonisht jepet një gjobë me kusht ose burgim me kusht.

Prokuroria publike vendos,

- o nëse procedura ndërpritet, pra nuk vazhdohet më tej - p.sh. nëse dyshimi nuk mund të vërtetohet dhe nuk ka prova të mjaftueshme;
- o nëse procedura do të përfundojë me urdhër-dënimi. Autori merr një gjobë dhe ju si viktimë merrni një kopje të urdhër – dënimit;
- o nëse çështja do t'i referohet një gjykate (veçanërisht në rastin e dënimeve më të larta). Gjykata vendos për dënimin dhe të drejtat financiare (zhdëmtimin dhe dëmshpërblimin).

### Të drejtat më të rëndësishme të viktimës në procedurën penale

- Ju mund të shoqëroheni nga një person i besuar gjatë gjithë hetimeve, për mbështetje morale. Megjithatë, duhet të jetë një person që nuk konsiderohet si dëshmitar/e.
- Mund të kërkonti që të mos keni takim të drejtpërdrejtë me personin e akuzuar gjatë gjithë procedurës penale (duke përfshirë edhe takimet e rastësishme në korridorin e ndërtesës së zyrës). Kjo do të thotë që marrja në pyetje të zhvillohet në dhoma të veçanta me transmetim video. Avokatja/avokati i personit të akuzuar ka të drejtë të jetë e/i pranishëm kur ju merreni në pyetje.
- Ju do të informoheni për arrestimin, arratisjen dhe lirimin e autores/autorit të veprës nga paraburgimi, përveç nëse e refuzoni shprehimisht këtë.

- Me pëlqimin tuaj, Beratungsstelle Opferhilfe mund të shikojë dosjet e autoriteteve të ndjekjes penale.
- Ju mund të kërkonte që prokuroria publike t'ju informojë për vendimin.
- Me një kërkesë me shkrim, ju mund të kërkonte që autoriteti ligjzbatues t'ju informojë për sa vijon:
  - data e fillimit të dënimit të personit të dënuar;
  - ku dhe si kryhet dënimi;
  - lirimi me kusht ose përfundimtar;
  - arratisja e personit të dënuar dhe përfundimi i saj.
- Në procedurat penale kundër integritetit seksual, ju mund të kërkonte që publiku të përjashtohet nga seanca gjyqësore. Megjithatë, gjykata mund ta refuzojë kërkesën tuaj.
- Si viktimë e një veprë penale kundër integritetit seksual, ju keni të drejtë të mos u përgjigjeni pyetjeve që kanë të bëjnë me sferën intime të privatësisë tuaj.
- Si viktimë e një veprë penale kundër integritetit seksual, ju mund të kërkonte që të merreni në pyetje nga një person i së njëjtës gjini në polici dhe në prokurorinë publike, si dhe që të paktën një person i së njëjtës gjini të jetë i pranishëm në gjykatë. Viktimat që flasin një gjuhë të huaj mund të kërkojnë, gjithashtu, që personi që përkthen të jetë i së njëjtës gjini.

### **Të drejta shtesë të të miturve si viktima**

- Marrja e parë në pyetje duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe kryhet nga një efektive/efektiv policie i trajnuar për këtë qëllim. Një person i trajnuar psikologjikisht është gjithashtu i pranishëm për të vëzhguar marrjen në pyetje, për t'u siguruar që ajo të kryhet në një mënyrë të përshtatshme për fëmijët.
- Marrja në pyetje regjistrohet në video. Megjithatë, për disa vepra penale kjo mund të shmanget.
- Në përgjithësi, fëmijët nuk duhet të merren në pyetje më shumë se dy herë.
- Nëse pritet që fëmija të jetë nën ngarkesë të rëndë psikologjike, nuk duhet të ketë ballafaqim me personin e akuzuar. Në këtë rast, personi i akuzuar dhe avokatja/avokati mbrojtës mund të bëjnë pyetje vetëm nëpërmjet efektives/efektivit të policisë.
- Fëmijët që nuk janë ende 15 vjeç në kohën e marrjes në pyetje, pyeten si informatorë dhe nuk janë të detyruar të japin dëshmi.

Ju lutemi vini re që, në procedurën penale për autoret/autorët e mitur zbatohen rregulla të ndryshme, pasi zbatohet procedura penale për të miturit.

### **Kostot e shërimit**

Kostot e shërimit përfshijnë kostot për shërbimet mjekësore, kujdesin spitalor, faturat e ambulancës dhe terapi të tjera të udhëzuara nga mjeku, të tilla si fizioterapia apo psikoterapia. Nëse jeni të punësuar apo jeni të regjistruar në fondin e sigurimit të papunësisë, duhet t'i dorëzoni këto fatura përkatësisht, në sigurimin e aksidenteve të punëdhënësit tuaj, ose në fondin e sigurimit të papunësisë. Për ta bërë këtë, ju duhet të kontaktoni punëdhënësin tuaj ose të bëni një raport aksidenti në fondin e sigurimit të papunësisë. Në të gjitha rastet e tjera, dorëzoni faturat për shpenzimet mjekësore në kompaninë tuaj të sigurimit shëndetësor.

Nëse keni shpenzime shërimi që nuk mbulojnë nga sigurimi ose nga autori i veprës, këto shpenzime mund të paguhet nga Ndihma për Viktimat.

## **Kërkesat për dëmshpërblim dhe zhdëmtim**

Nëse dëshironi të parashtroni pretendime për dëmshpërblim dhe zhdëmtim kundrejt autorit të veprës, këto kërkesa mund të paraqiten si padi civile në procedurë penale. Për ta bërë këtë, ju duhet të pozicionoheni herët si paditëse/paditës privat në procedurën penale. Bëni një listë të shpenzimeve me faturat përkatëse dhe paraqiteni këtë listë në seancën e marrjes në pyetje.

Dëmet dhe kostot e shkaktuara nga vepra penale përfshijnë si p.sh.:

- veshje dhe këpucë të dëmtuara ose të shkatërruara
- humbje pagash ose të ardhurash
- shpenzime telefoni dhe udhëtimi
- shpenzimet që nuk mbulohen nga sigurimi shëndetësor ose sigurimi i aksidenteve

Zhdëmtimi, i ashtuquajtur i kompensim i dhimbjeve dhe vuajtjeve, është i mundur,

- nëse vepra penale ka lënë pas dëme fizike dhe/ose psikologjike;
- nëse mbetet një kufizim profesional dhe/ose privat;
- nëse procesi i shërimit ishte shumë i dhimbshëm, jashtëzakonisht i gjatë ose jashtëzakonisht i vështirë.

## **Afatet për dëmshpërblim dhe zhdëmtim të Ndihmës për Viktimat**

Nëse keni të drejtë për dëmshpërblim dhe/ose zhdëmtim, dhe kjo nuk paguhet për shkak se autori i veprës është i panjohur ose i paaftë për të paguar, këto kërkesa me kushte të caktuara mund të trajtohen nga Ndihma për Viktimat.

**Ju lutemi vini re:** Këto pretendime duhet të raportohen te Ndihma për Viktimat brenda 5 viteve nga data e veprës, përndryshe ato do të skadojnë. Kushdo që ka qenë viktimë e një krimi të rëndë si i mitur, mund të paraqesë një kërkesë deri në ditëlindjen e tij të 25-të. Pas kësaj nuk ka më asnjë të drejtë.

**Ne do të jemi të lumtur t'ju ofrojmë informacione të mëtejshme përmes telefonit, ose në një bisedë personale. Falas dhe konfidenciale!**